



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 05, datë 01.08.2023

**PËR**  
**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT TË INFRASTRUKTURËS:**  
**“PARKU NATYROR “LIQENI I ULZËS” DHE ZONA E MBROJTUR PËRRETH TIJ”,**  
**ME VENDNDODHJE NË BASHKITË MAT, MIRDITË DHE KURBIN**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të zhvilluesit Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**


1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit të Infrastrukturës: “Parku Natyror “Liqeni i Ulzës” dhe zona e mbrojtur përreth tij”, me vendndodhje në Bashkitë Mat, Mirditë dhe Kurbin, me zhvillues Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
  - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
  - b) pagesës përkatëse të taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkive Mat, Mirditë dhe Kurbin.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.



MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT  
MIRELA KUMBARO FURSHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT  
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 23 07 / 2024